



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/0926

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Kimete Gashi Brajshori duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) DWH - ALBANIA SHPK, kundër Njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit të KUVENDI KOMUNAL I KLINËS në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit Dron për matje gjeodezike dhe inspektim me numër të prokurimit 634-25-8283-1-3-6, me 07/11/2025, mori:

Vendim

1. **Aprovohet**, si e bazuar ankesa e DWH - ALBANIA SHPK., me nr. 2025/0926, e datës 19.09.2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit Dron për matje gjeodezike dhe inspektim me numër të prokurimit 634-25-8283-1-3-6, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – KUVENDI KOMUNAL I KLINËS.
2. **Anulohet** njoftimi për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit Dron për matje gjeodezike dhe inspektim me numër të prokurimit 634-25-8283-1-3-6, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – KUVENDI KOMUNAL I KLINËS. Obligohet AK që të bëjë përmirësimet e dosjes së tenderit dhe të zgjas afatin për ofertim.
3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP-në për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën për mos respektim të vendimit, OSHP mund të ndërmarrë masa ndaj AK sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës.
4. Meqenëse ankesa e OE ankues aprovohet si e bazuar, bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.
5. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 10.09.2025, KUVENDI KOMUNAL I KLINËS., në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar B05 Njoftimi për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit Dron për matje gjeodezike dhe inspektim me numër të prokurimit 634-25-8283-1-3-6.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 7,500.00 €.

Me 11.09.2025, OE DWH - ALBANIA SHPK, ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 17.09.2025, Autoriteti Kontraktues e ka refuzuar si të pabazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 19.09.2025, OSHP ka pranuar ankesën nga OE DWH - ALBANIA SHPK., me nr. 2025/0926 lidhur me aktivitetin Dron për matje gjeodezike dhe inspektim me numër të prokurimit 634-25-8283-1-3-6.

- Mbi fazën e shqyrtimit paraprak -

Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues DWH - ALBANIA SHPK, janë parashtruar si në vijim:

Kërkesa për pajisjen e kompanisë me ISO

Kundërargumenti 1.1: LPP të BE-së, i cili është pjesë integrale e LPP të RK si gërmë dhe frymë dhe në të cilin bazohet tërësisht LPP e RK, nuk kushtezon në asnjë nen të tij pjesëmarrjen në tender me certifikata ISO për firmat tregtare dhe më gjerë. Kundërargumenti 1 do të mjaftonte për AK që të tërhiqej nga kjo kërkesë artificialisht kufizuese në pjesëmarrje të OE.

Kundërargumenti 1.2: AK i referohet për këtë argument LPP 04/L-042, Neni 65. Neni 65 as që bën fjalë për aftësinë teknike-profesionale të OE, por për përshtatshmërinë juridike të OE (mospjesëmarrje në përgatitje të tenderit, të mos jetë i dënuar më parë, të mos jetë në proces). Nuk po e komentojmë më gjatë këtë fakt, sepse qëllimi ynë nuk është keqdashës.

Kundërargumenti 1.3: Produkti i kërkuar nga AK është droni. Droni në Geomatic është instrumenti më pak i saktë dhe që nuk kërkon asnjë kusht (aftësi) paraprak për t'u përdorur. Vetëm në vitin 2025 janë hapur disa tendera për drone të kësaj kategorie nga komuna të ndryshme dhe askund nuk ka pasur kërkesa si këto të AK-së së Klinës. Ky fakt, për këdo që ka integritet dhe njohuri për ligjin, është dëshmi e mjaftueshme që këto kërkesa janë sforcim i pakuptueshëm dhe i panevojshëm i AK-së.

Kundërargumenti 1.4:Çfarë është certifikata ISO9001? Certifikata ISO9001 është një certifikatë që vërteton implementimin e një procesi prodhimi apo shërbimi në një kohë të dytë (pas 1, 2 apo më shumë muajve). Kjo certifikatë vlen për kompani prodhimi dhe/ose shërbimi komplekse.

Shembulli 1, prodhim:Hyrja e lëndës/lëndëve të para në kompani nga liferanti nëpërmjet doganës ose joKontrolli i lëndëve të paraDalja e lëndëve të para për në proces prodhimiKontrolli i gjendjes dhe sasivePërgatitja dhe/ose kontrolli i linjës së prodhimitFutja në prodhimProdukti paraprak dhe/ose përfundimtarKontrolli i cilësisëRuajtja e një ose më shumë mostrave (për ritestim)AmbalazhimiMagazinimiDalja për te klienti dhe kontrolliMarrja nga liferantiDorëzimi dhe konfirmimiDepozitimi i dëshmisë së marrjes

Në këtë proces në etapa të ndryshme angazhohen persona të ndryshëm, ku çdo proces dhe person dokumentohet. Nëpërmjet mostrës dhe produktit të reklamuar, në rast reklamimi, ky proces mund të rivizitohet në një fazë të dytë dhe të përcaktohet se në cilën etapë ka ndodhur anomalia dhe cilët persona janë përgjegjës. Ky është qëllimi i ISO.

Shembulli 2, Shërbim (p.sh. spital):Administrimi i të dhënave të pacientitVizita te Dr. SpecialistAnalizat e rekomanduara nga Dr. në laborator (ku ruhet një sasi gjaku)Rivizita e Dr. pas daljes së analizaveRekomandimi i terapisë

I gjithë ky proces është i rivizitueshëm në një fazë të dytë. Në bazë të këtij procesi qëndron ruajtja e të dhënave në një database të pamundësishme për ndryshim në një fazë të dytë. Pra, në bazë të këtyre qëndron një software.

Pra, siç edhe shihet, ISO nuk është proces i nevojshëm për kompani tregtare. Shumica e kompanive tregtare në këtë fushë, si edhe na rezulton nga rishikimi i dosjeve në tendera të ndryshëm, operojnë për përgatitjen e faturave dhe shkresave me Word dhe Excel, që lejojnë ndryshimin e dokumenteve (faturave, shkresave) në kohë të mëvonshme. Kjo është "no go" për ISO.

Kompania jonë operon me software të punës së saj (ruajtja e klientëve, lista e produkteve, shkresat, ofertat, listat e dërgesave dhe faturat), i cili është i certifikuar në BE (Gjermani) dhe është online (i instaluar në servera të Gjermanisë), i cili siguron ruajtjen e çdo dokumenti në mënyrë të pandryshueshme. Kjo, për një firmë tregtare, është më shumë se çdo ISO.

Kundërargumenti 1.5:AK ka zhvilluar këtë vit një tender për një produkt geomatic më të komplikuar, më të saktë dhe që kërkon njohuri gjeodezike (GPS) dhe nuk i ka parashtruar këto kërkesa. Si shpjegohet që për GPS nuk kërkon asnjë nga këto kërkesa dhe për dron i kërkon?!

Konkluzioni 1:Kërkesa për ISO është kërkesë që bie ndesh me LPP të RK 04/L-042, Nenin 1 dhe Nenin 7.

2. Certifikata e Drejtorisë së Aviacionit të Kosovës

Kjo kërkesë është pa përmbajtje dhe e pabazuar.

Kundërargumenti 2.1: Regjistrimi i poseduesit të dronitKategoria e këtyre droneve është “drone vetfluturues” dhe as ligji europian dhe as ligji kosovar nuk e ka kusht regjistrimin e shitësit me certifikatë dron-drejtimi.

Kundërargumenti 2.2: Regjistrimi i dronit

Certifikata e Drejtorisë së Aviacionit nuk ka për qëllim personin, por dronin, sepse “dronet” janë objekte vetfluturuese. Leja për çdo fluturim i jepet poseduesit në emër të dronit. AK do duhet të nxjerrë lejen në Drejtorinë e Aviacionit sa herë që ata do të masin me dron, ku do duhet të njoftojnë kohën e ngritjes, sipërfaqen e fluturimit, koordinatat, qëllimin, etj.

Kjo kërkesë nuk ka asnjë lidhje me kompaninë liferuese. Nëse ju do të blini një autoveturë, do duhet të bëni regjistrimin e autoveturës, të nxirrni targat (tabelat) e autoveturës, të bëni kontrollin teknik një herë në vit dhe të gjeni edhe një ose më shumë shoferë. Të gjitha sa më sipër janë obligime të domosdoshme, por këtë nuk mund t’ia kërkon kompanisë shitëse.

Konkluzioni 2:

Kjo kërkesë bie ndesh me LPP të RK 04/L-042, Nenin 1 dhe Nenin 7.

3. Menaxheri i Kontratës të ketë master dhe mbi 5 vjet eksperiencë pune

Kjo kërkesë është jo vetëm një kulminacion në qasje ekstreme dhe agresive e AK-së. Kjo kërkesë është lehtësisht e realizueshme, por për hir të vërtetës na duhet ta luftojmë, pavarësisht nga raporti i kërkesës me kompaninë tonë.

Kundërargumenti 3.1: Master Gjeodezie?!

Universiteti i Kosovës, Fakulteti i Gjeodezisë, nuk përgatit Master në gjeodezi. Në këto kushte, të kufizosh garën në një kërkesë që mungon në tregun kosovar përbën një nonsens të çuditshëm. Nuk mund të kërkojë noter në shkretëtirë.

Kundërargumenti 3.2: Master për dron

Droni është instrument matës geomatic si Stacioni Total ose GPS. AK nuk kërkon Master kur ka blerë GPS, por kërkon Master për dron. Se ku është lidhja ndërmjet dronit dhe masterit nuk kuptohet. Shoferi që përgatit djemtë dhe vajzat kosovare për të drejtuar autoveturën apo kamionin apo avionin nuk është Master. Pse kërkohet Master për dronin?

Kundërargumenti 3.3: Përdoruesi pa master?!

Përdoruesi i dronit do duhet ta përdorë atë vazhdimisht, por për këtë nuk kërkohet master. Si shpjegohet kjo anomali që liferuesi me master, kurse përdoruesi pa master?

Konkluzioni 3:

Kjo kërkesë nuk ka asnjë lidhje me objektin e tenderit dhe bie ndesh me LPP 04/L-042, Nenin 1 dhe 7.

I kërkojmë OSHP-së të ndihmojë AK-në që të vendosë tenderin në shtratin ligjor, duke fshirë kërkesat antiligjore që devijojnë tenderin tek ofertuesi që ka ISO, por me siguri do të rezultojë fillestar në fushën e gjeodezisë. Ne do e mbajmë në monitorim tenderin, ku do kemi mundësinë të gjejmë edhe arsyt praktike pse dhe për llogari të kujt OE janë devijuar, limituar dhe shtrembëruar kërkesat e tenderit, sapo të njihemi me dosjen e OE që do rezultojë se përmbush këto kërkesa të çuditshme.

Përgjigje në kërkesën për rishqyrtim:

Përgjigje për O.E.

Lidhur me pretendimin tuaj që kundërshton kërkesën në dosjen e tenderit për certifikatat ISO, ju njoftojmë se kërkesa për certifikatat ISO (p.sh. ISO 9001 për menaxhimin e cilësisë dhe ISO 27001) nuk është vendosur në mënyrë arbitrare apo diskriminuese, por është pjesë përbërëse e kriterëve të kapaciteteve profesionale dhe teknike, të cilat autoriteti kontraktues ka të drejtë t'i përcaktojë në përputhje me nenin 65 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës (LPP). Sipas këtij neni: "Autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatorët ekonomikë të ofrojnë dëshmi për përmbushjen e kërkesave përkatëse të përcaktuara në dosjen e tenderit, në lidhje me kapacitetin e tyre profesional, teknik dhe menaxherial për realizimin e kontratës."

Përgjigje për O.E.

Kërkesa për certifikatën nuk është në kundërshtim me frymën e tenderit, por është një kusht i domosdoshëm për zbatimin ligjor dhe korrekt të aktivitetit që lidhet me përdorimin e dronit në Kosovë dhe për këtë arsye do të mbetet pjesë e kriterëve të tenderit. Qëllimi i kësaj kërkesë është të sigurojë që përdoruesit e dronëve janë të informuar dhe respektojnë detyrimet ligjore, rregulloret për sigurinë ajrore, si dhe kufizimet dhe procedurat për përdorimin e pajisjeve në hapësirën ajrore të Kosovës. Edhe pse operatori ekonomik ofron pajisjen (dronin) dhe nuk është përdorues i drejtpërdrejtë i tij në terren, për realizimin e kontratës dhe përdorimin në mënyrë ligjore dhe të sigurt të dronit në Kosovë është thelbësore që operatori të posedojë ose të sigurojë certifikatën për përdorimin e tij nga Drejtoria e Aviacionit Civil, nëse përdorimi do të kryhet nga vetë operatori ose në emër të tij. Sa i përket operatorëve të huaj, ligji dhe rregulloret parashikojnë mundësinë e njohjes së certifikatave ekuivalente ose procedurave për pajisje me autorizime të përkohshme për përdorim në Kosovë, në bashkëpunim me Drejtorinë e Aviacionit Civil, për të garantuar respektimin e kërkesave ligjore dhe sigurinë ajrore.

Përgjigje për O.E.

Lidhur me pretendimin tuaj se kërkesa për një menaxher kontrate me master dhe mbi pesë vite eksperiencë pune nuk ka lidhje me objektin e tenderit dhe është e paarsyeshme për një tender furnizimi me drone gjeodezik, sqarojmë sa vijon: Edhe pse tenderi ka kategorinë "furnizim me mall", vlera dhe kompleksiteti i pajisjes së kërkuar (dron gjeodezik) kërkon edhe një menaxhim adekuat të kontratës për realizimin e plotë dhe të suksesshëm të furnizimit, duke përfshirë aspektet teknike, administrative dhe koordinimin me autoritetin kontraktues. Kërkesa për master dhe mbi pesë vite përvojë është një kriter i arsyeshëm dhe proporcional, duke pasur parasysh rëndësinë teknike dhe menaxheriale të objektit të tenderit, sidomos për pajisje të specializuara si droni gjeodezik, i cili përdoret për matje të saktësisë së lartë në fushën gjeodezike.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 22.09.2025 ka autorizuar ekspertin/teknik për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 0926/2025, ndërsa me datë 25.09.2025 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues/teknik me nr. 2025/0926 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, AK të bëjë përmirësimet në dosje të tenderit dhe të zgjasë afatin për ofertim.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale, Autoriteti kontraktues nuk është pergjigjur rreth raportit të ekspertit shqyrtues ndërsa OE pajtohet rreth raportit të ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marrë parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritator lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE DWH - ALBANIA SHPK, eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2025/0926 ka vlerësuar si në vijim:

Sqarim Hyrës

Autoriteti Kontraktues – Kuvendi Komunal i Klinës, gjatë këtij aktiviteti ka aplikuar procedurën e koutimit të çmimit, vlerë e vogël, lloji i kontratës furnizim, vlera parashikuar e kontratës është 7500.00€

AK me dt. 10.09.2025 ka publikuar Njoftimin për kontratë ndërsa hapja e ofertave fillimisht ishte planifikuar të bëhet me dt. 16.09.2025 vlenë të ceket fakti se AK pikërisht me dt.16.09.2025 kishte publikuar njoftimin për korigjimin e procedurës duke e zgjatur afatin për ofertim me dt. 26.09.2025 me arsyetimin se janë duke shqyrtuar kërkesen për ri-shqyrtim.

Kundër njoftimit për kontratë AK ka pranuar kërkesën për ri-shqyrtim, ndaj kriterëve të aplikuar nga AK në dosje të tenderit dhe njoftim për kontratë. AK, ka nxjerr vendim mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim si të pabazuar, vlenë të ceket fakti se AK kishte dhënë sqarime të përgjithshme ndaj pretendimeve ankimor, me ç'rast OE ankues, nuk është pajtuar dhe brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë në OSHP me pretendime ankimore të njëjta si në kërkesen për ri-shqyrtim.

Përgjigje në Pretendimet e OE ANKUES

Pas administrimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës, sqarojmë se pikënisja e problemit ka të bëjë me atë se për aktivitetin e prokurimit në fjalë, OE ankues pretendon se AK-ja ka aplikuar kritere diskriminuese, favorisuese, dhe jopropercionale me natyrën e aktivitetit të prokurimit kurse AK nuk ka paraqitur ndonjë argument përmes të cilave arsyetohen kërkesat e aplikuar në dosje të tenderit.

Eksperti Shqyrtues sqaron se, bazuar në analizën e fakteve / dëshmive të dokumentuara në platformën elektronike E-prokurimi, AK në dosje të tenderit tek kapaciteti teknik dhe profesional kishte aplikuar një numër të madh të kriterëve si certifikata EN-ISO ISO 9001 2015, ISO 27001, autorizim nga prodhuesi, menaxheri i projektit me 5 vite përvojë pune, kontrata të realizuara në tri vite e fundit të natyrës së ngjashme, kurse dëshimia e kërkuar është e

natyrës së njejtë, qarkullim ekonomik etj, edhe pse procedura ishte furnizim me vlerë të vogël kuotim i cmimit.

Kriteret e aplikuara nga AK në dosje të tenderit dhe të kundërshtuara nga OE ankues janë si në vijim;

Kërkesa . Operatori Ekonomik duhet të ketë certifikatat lidhur me kërkesat teknike; ISO 9001 2015, ISO 27001.

Dëshmia . Certifikatat ISO të skanuara nga origjinali

Kerkese- Operatori Ekonomik duhet të ketë një menaxher të projektit Master i Gjeodezisë me përvojë pune min. 5 vite i njëjti duhet të jetë i Çertifikuar nga Autoriteti i Aviacionit për përdorim të mjeteve Ajrore pa Pilot(SPA)

Diplomen-kopje me kontratë apo parakontratë në emër të projektit (vendim për Projektmenaxherin i vulosur dhe nënshkruar nga kompania dhe inxhinieri) si dhe CV e nënshkruar nga vet inxhinieri, dëshmitë për përvojën e punës dhe referenca

Eksperti sqaron se, bazuar në platformën elektronike e-prokurimi AK ka publikuar Njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit. AK në ankesën 1 të dosjes së tenderit kishte përcaktuar specifikat teknike, të cilat duhet të posedojë pajisja (Droni) me të cilën do të furnizohet AK. Por, AK askund në dosje të tenderit nuk kishte kërkuar që OE duhet edhe të vë në funksion pajisjen (Dronin) e njëjtë. Se kërkesat e vendosuar nga AK janë jo proporcionale dhe nuk kanë të bëjnë me natyrën e aktivitetit të prokurimit, e dëshmon edhe arsyetimi i dhënë nga AK në përgjigje ndaj refuzimit të kërkesë për ri-shqyrtim të parashtruar nga OE ankues, se një kërkesë e tillë nuk është diskriminuese por është pjesë përbërëse e kriterëve të kapaciteteve teknike profesionale, të cilat autoriteti kontraktues ka të drejtë të përcaktojë në përputhje me nenin 65 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurim Publik në republikën e Kosovës. Eksperti shqyrtues sqaron se, kriteret e kapacitetit teknik dhe profesional duhet të jenë në përputhje me nenin 69 të LPP-së dhe jo me nenin 65 siç e ka arsyetuar AK, në përgjigjen e saj. Për ta ç’artësuar këtë problematik KRPP-ja ka nxjerr interpretimin ligjor sa i përket aplikimit të EN-ISO si në vijim; 26. 09.06.2023 A lejohet me LPP të kërkohen Certifikata ISO, kur qartë vërehet se shumica e tyre nuk kanë ndonjë lidhshmëri me objektin e kontratës?

Konform nenit 87, paragrafit 2, nën paragrafit 2.8 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-237, Ligjin nr. 05L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në pyetjen e parashtruar, KRPP ofron interpretimin ligjor si në vijim:

Duke qenë se në të shumtën e rasteve, Autoritetet Kontraktuese në dokumentet e tenderit (Dosjen e tenderit dhe Njoftimin për Kontratë), po vendosin kërkesa dhe kritere diskriminuese duke specifikuar dëshmi-Certifikata të ndryshme në emër të kualitetit, pa pasur ndonjë lidhshmëri ndërmjet lëndës së aktivitetit të prokurimit (objektit të kontratës) dhe cilësisë së synuar.

Në përputhje me paragrafin 2 të nenit 24 të LPP-së, “Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj”.

Gjatë ekzekutimit të aktiviteteve të prokurimit, autoriteti kontraktues është i obliguar që në çdo fazë të aktivitetit të prokurimit, t’i respektojë dhe zbatojë parimet themelore të prokurimit të përcaktuara me këtë ligj.

Në përputhje me paragrafin 2 të nenit 7 të LPP-së, “Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shumë operatoreve ekonomik”.

Gjithashtu, me paragrafin 3 të këtij neni rreptësishtë i ndalohet autoritetit kontraktues, përveç tjerash, që në Dosjen e tenderit dhe në Njoftimin për kontratë të vendosë kërkesa ose kritere të përzgjedhjes që në një mënyrë kanë për qëllim të favorizojnë apo diskriminojnë një apo më shumë operator ekonomik.

Në përputhje me paragrafin 1 të nenit 51 të LPP-së autoriteti kontraktues duhet të përcaktojë kriteret e përzgjedhjes në Dosjen e tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë që një OE duhet t'i plotësojë për tu konsideruar i kualifikuar (i përgjegjshëm). “Të gjitha kriteret e përzgjedhjes duhet të kufizohen vetëm në kriteret e nevojshme për të siguruar se vetëm operatorët ekonomik që posedojnë aftësitë e nevojshme profesionale, financiare dhe teknike për t'i përmbushur kushtet e kontratës përkatëse do të konsiderohen të kualifikuar për të marrë një kontratë të tillë ose për marrjen e ftesës për tenderim...”.

Ndërsa paragrafi 3 i nenit 51 të LPP-së në mënyrë rigoroze përcakton se, “Të gjitha kriteret e përzgjedhjes si dhe dokumentet dhe informatat e kërkuara që janë vendosur dhe përshkruar në këtë nen, duhet të jenë drejtpërdrejt relevante dhe proporcionale në raport me lëndën e kontratës përkatëse”.

Në vazhdim në përputhje me paragrafin 2.5 të nenit 69 të LPP-së autoriteti kontraktues mund të kërkojë, “Certifikata të hartuara nga institutet zyrtare për kontrollimin e cilësisë ose agjencitë kompetente të pranuar që vërtetojnë përshtatshmërinë e produkteve, që qartazi mund të identifikohen duke u bazuar në specifikimet dhe standardet përkatëse”.

Bazuar në këtë, KRPP rekomandon zyrtarët e prokurimit që me rastin e vendosjes së kriterëve apo kërkesave kualifikuese të kenë parasysh që mund të kërkojnë vetëm ato Certifikata që janë ngushtë të lidhura me sigurimin e cilësisë dhe kualitetit të lëndës së prokurimit.

Në këtë kontekst është për tu habitur se, AK ka aplikuar procedurën e koutimit të çmimit, furnizim vlerë e vogël, që nënkupton se AK vetëm ka me u furnizuar me pajisjen (dronin) e kërkuar, dhe se nuk ka ndonjë specifikim teknik apo kërkesë shtesë që OE (furnizuesi) do të kryej edhe shërbime tjera shtesë me pajisjen e kërkuar nga AK. Përkundër kësaj, AK në dosje të tenderit ka aplikuar kërkesa që OE (furnizuesi) të jetë i certifikuar me EN-ISO 9001-2015 dhe ISO 270001, Operatori Ekonomik duhet të ketë autorizim nga prodhuesi ose distributori dhe kërkesën tjetër që menaxheri i projektit, duhet të jetë Master i Gjeodezisë me përvje pune min. 5 vite i njëjti duhet të jete i Certifikuar nga Autoriteti i Aviacionit për përdorim të mjeteve Airore pa Pilot(SPA). Andaj, vlerësojmë se në rastin konkret kërkesat e vendosur nga AK në dosje të tenderit, sa i përket certifikimit me EN-ISO për menaxhim të cilësisë të “furnizuesit”, kërkesa për menaxherin e kontratës janë në kundërshtim me nenin 51 pika 3 e LPP-se, nenin 25.6 të rregullores për prokurim publik dhe interpretimin e KRPP nr 26 të datës 09.06.2026, përmes të cilave sqarohet se, të gjitha kriteret e përzgjedhjes të cilat vendosen nga ana e autoritetit kontraktues në dosjes të tenderit, duhet të jenë relevante dhe proporcionale në raport me aktivitetin e prokurimit. Duke analizuar natyrën e këtij aktivitetit të prokurimit, vlerësojmë se kriteret e vendosura nga AK në dosje të tenderit, të cilat janë ankumuar nga OE ankues përmes ankesës, nuk janë kritere relevante dhe në përputhje me këtë aktivitet prokurimi ashtu siç e

kërkon legjislacioni në fuqi. Andaj konsiderojm se kriteret e aplikuara për EN-ISO dhe menaxher të projektit duhet të ndryshohen nga AK dhe të harmonizohen me specifikat teknike të paraqitura tek aneksi 1 i dosjes së tenderit. Bazuar në konstatimet e lartecur vleresojm se pretendimet e palës në ankesë janë të qëndrueshme.

Si përfundim, eksperti shqyrtues, po ashtu sqaron se bazuar në nenin 17.15 të rregullores për prokurimin publik nr 001/22, vendosja e kriterëve të përzgjedhjes është përgjegjësi e zyrtarit të prokurimit, andaj mbetet në përgjegjësi dhe diskrecion të Autoritetit kontraktues, respektivisht ZPP-së që vendosja e kriterëve të bëhet në harmoni të plotë me natyrën e aktivitetit të prokurimit në atë mënyrë që lejonë trajtim të barabartë më mes të operatorëve ekonomik dhe të arrihet qëllimi i LPP-se dhe vlera për parën.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit dhe analizimit të të gjithë dokumentacionit në platformën e e-prokurimit, pretendimeve ankimore, përgjigjeve të dhëna nga eksperti i çështjes i angazhuar nga OSHP, konsideron se raportet e ekspertizës i përmbajnë apriori elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilave dispozita kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë panelin dhe të gjitha palët me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore. Mirëpo duhet theksuar se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Paneli Shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkelleve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit. Prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, ndonjë raport dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjyqimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të LPP.

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e Dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit Dron për matje gjeodezike dhe inspektim me numër të prokurimit 634-25-8283-1-3-6.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e eksperti shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik aprovohet si e bazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull Dron për matje gjeodezike dhe inspektim me numër të prokurimit 634-25-8283-1-3-6, AK të bëjë përmirësimet në dosje të tenderit dhe të zgjasë afatin për ofertim. Në mbështetje të asaj që u përshkruara si më lartë, rrjedhimisht paneli shqyrtues konstaton qe ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, AK të bëjë përmirësimet në dosje të tenderit dhe të zgjasë afatin për ofertim.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë

një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 131 të LPP lidhur me nenin 29 paragrafin 3 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Kimete Gashi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI KOMUNAL I KLINËS**
- **OE - DWH - ALBANIA SHPK**
- Arkivës së OSHP-së: